



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË

SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Mars 2016

Drejtori i Ri i Ujësjetllës Kanalizime Shkodër, Mark Molla, Vepron me Shpejtësi për Përmirësimin e Shërbimit ndaj Konsumatorëve



Deri dy muaj më parë ishte e vështirë të besohej se në qytetin e Shkodrës furnizimi me ujë do të normalizohej në një kohë të shkurtër. Shkodra nuk ka vuajtur nga

mungesa e burimeve ujore, përkundrazi i ka me bollëk, por ka vuajtur nga keqadministrimi i ujit dhe përgjegjësia për këtë binte direkt mbi shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Shkodër. Drejtori i ri, Mark Molla, i cili ka vetëm gjashtë muaj në këtë post, i tha stafit të tij që në ditën e parë në detyrë, “ne nuk na lejohet që qytetarët të mos i furnizojmë me ujë të pijshëm rregullisht, pasi për këtë na kanë besuar dhe për këtë paguhemi” [.lexo më shumë](#)

Çfarë ka të Re në SHUKALB?

Hapet Regjistrimi për Kurset e Trajnimit!

SHUKALB ka hapur regjistrimet për dy kurset e para të trajnimeve që do të jepen në mars:

- Manaxhimi i Humbjeve të Ujit I, 17-18 mars 2016, Tiranë
- Cilësia e Ujit në Sistemin e Shpërndarjes, 28-29 mars 2016, Tiranë

Për më tepër informacion rreth këtyre kurseve të trajnimit klikoni [këtu](#).



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri...

Eventet e Ardhshme!

[Manaxhimi i Humbjeve të Ujit I, 17-18 mars 2016, Tiranë](#)

[Cilësia e Ujit në Sistemin e Shpërndarjes, 28-29 mars 2016, Tiranë](#)

Upcoming Programs!

Për t'u regjistruar në secilën prej këtyre kurseve të trajnimit klikoni [këtu](#).

SHUKALB Organizon Mbledhjen e Parë Bordit të Ri dhe Mbledhjen e Asamblesë së Shoqatës



Pas përfundimit të procesit të zgjedhjeve për anëtarët e rinj të Bordit të Drejtorëve për mandatin tre vjeçar 2016-2018, SHUKALB organizoi Mbledhjen e parë me përfaqësuesit e zgjedhur të Bordit të ri. Mbledhja u mbajt më 12 shkurt dhe u fokusua në njohjen e Bordit me Buxhetin dhe aktivitetet e planifikuara nga SHUKALB për vitin 2016. [lexo më shumë](#)

Semira Kasimati Raporton nga Workshopi i Këshillit Strategjik të IWA-së mbi Zhvillimin e Kapaciteteve dhe Strukturën e Kompetencave



Semira Kasimati, përfaqëson anëtarin privat të Shoqatës, Valu Add Management Services dhe është emëruar kohët e fundit si anëtare e Këshillit Strategjik të Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA), ku përfaqëson firmat e vogla të konsulencës në vendet në zhvillim. Këshilli Strategjik u takua më datë 9 shkurt, në Hagë, për të diskutuar tematikat dhe t'i rekomandojë Bordit të IWA-së mbi drejtimet që IWA duhet të marrë për çështjet e rëndësishme në sektorin e ujit. Një nga katër fushat prioritare strategjike të Planit Strategjik 2014-2016 të IWA-së ka për qëllim të shndërrojë IWA në një organizatë e cila lehtëson mësimin e anëtarëve të saj. Ajo ka për qëllim të vlerësojë mundësitë për të rritur përvojën e të mësuarit të anëtarëve, si individualë ashtu dhe të korporatave, duke u bazuar në pikat e forta aktuale të IWA-së. [lexo më shumë](#)

-World Water Day - 22 March 2016
-Friends of Water Program March 2016
- World Water Monitoring Challenge - March 2016
-Internship Program - March 2016

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Lajme nga Anëtarët tanë

Publikimi i BE-BAZH Prezanton Historinë e Suksesit të Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Korçë



SHUKALB është krenar të ndajë një histori suksesti të anëtarit të saj, Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Korçë, botuar kohët e fundit nga projekti Instrumenti Lehtësues për Përgatitjen e Projekteve (PPF) i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Bashkëpunimi Austriak për

Zhvillim (BAZH). Artikulli flet për përfundimin e suksesshëm të projektit mbi Ndërtimin e Sistemit të Ujësjetllës Kanalizimeve në Korçë (Faza IV), i financuar nga BE-ja. Përveç ndikimit të investimeve dhe menaxhimit të mirë, drejtori Petrit Tare ua atribuon rezultatet e performancës së shkëlqyer, punonjësve të aftë dhe të motivuar të UK Korçë. Artikullin e plotë mund ta lexoni në linkun e mëposhtëm, në faqen 31 të raportit:

[PPF-Booklet.pdf](#)

Rrëshqitjet e Dherave Rrezikojnë Furnizimin me Ujë në Tepelenë dhe Memaliaj



Reshjet e rënda e të vazhdueshme gjatë muajit shkurt e kanë rënduar së tepërmi rrjetin e furnizimit me ujë nga burimi i fshati Benç për në qytetet e Tepelenës dhe Memaliaj.

Shkarjet e dheut kanë bërë që tubacioni kryesor i furnizimit me ujë të zhvishet duke e detyruar shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Tepelenë ta nxjerrë jashtë shërbimit duke i përmbushur nevojat e konsumatorëve nga burimet e tjera që disponon. Por situata është emergjente për shkak të afrimit të stinës së verës, gjatë së cilës shoqëria nuk do të mundë të përmbushë nevojat në rritje për ujë. [lexo më shumë](#)

Të tjera

Mundësi Grantesh nga Programi i Ujit për Danubin

Programi i Ujit për Danubin (Danube Water Program) ka hapur

një Thirrje për Aplikim për Grante Konkurese, të cilat kanë për qëllim mbështetjen e aktiviteteve për përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve të shoqërive ujësjellës lokalizime lokale, kombëtare dhe rajonale si dhe praktikat operacionale. Rastet që do të financohen duhet të jenë të ndërlidhura me aktivitetet e Programit të Ujit të Danubit siç përshkruhen në Planin e Punës ([i publikuar këtu](#)).

Vlen të theksohet se Programi i ujit të Danubit inkurajon aplikacionet që marrin mbështetje nga Shoqatat Kombëtare komunale të Ujit, në këtë rast SHUKALB.

Për më tepër informacion ju lutem vizitoni faqen e website të Programit të Ujit të Danubit: www.danube-water-program.org. Në këtë link mund të shkarkoni Thirrjen për Aplikime dhe Formularin e Aplikimit..

Pranimet e Aplikimeve mbyllen në datë **8 prill 2016**..

Me datë **9 mars** SHUKALB do të organizojë një workshop me pjesëmarrjen e shoqërive ujësjellës lokalizime duke i ofruar orientim në procesin e zhvillimit të aplikimeve, në mënyrë që të jenë në përputhje me kërkesat e Programit të Ujit të Danubit.

Trajnime dhe Mundësi Arsimimi

Edicioni i 19-të i Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren e Shërbimeve Publike | Torino, Itali | 05-16 shtator 2016

Shkolla e Rregulloreve Lokale të Torinos njofton se ka fhapur zyrtarisht aplikimet për Edicionin e 19-të të **Shkollës Verore Ndërkombëtare mbi Rregulloren e Shërbimeve Publike**.

Shkolla Verore u drejtohet studentëve të vitit të fundit, studentëve të diplomuar dhe zyrtarëve të Administratës Publike (bashkive, prefektuarave, organeve rajonale) dhe agjencive rregullatore.

Pjesëmarrësit që do të përzgjidhen do të mund të përfitojnë nga tarifat shumë të ulëta të regjistrimit; regjistrim falas për vendet jo anëtare të OBEZH (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) siç është Shqipëria dhe shteteve të

anëtarësuarë rishtaz në BE. Regjistrimi përfshin 2 javë **akomodim falas** në Torino.

Aplikimet janë të hapura. Afati: **5 qershor 2016**.

Për informacion të mëtejshëm dhe formën e aplikimit ndiqni linkun: www.turinschool.eu/iss

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trainimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, **Web:** www.shukalb.al